

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN LURË DIBËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Lurë, Dibër**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 89, datë 23.07.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 447/7, datë 23.07.2014, i ka rekomanduar z. Hakik Gjokola, Kryetar i Komunës Lurë, Dibër, zbatimin e masave të mëposhtme:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*” të ushtruar në Komunën Lurë për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Kryetari i komunës Lurë, të nxjerrë aktin administrativ për ngritjen e grupit të punës, në lidhje me zbatimin e procedurave në ngritjen e funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr 6296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” si dhe shkresën e MF nr. 6082, datë 16.03.2011 “*Mbi hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike mbi impletimin e këtij ligji*”.

Menjëherë

2. Komuna Lurë për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël, të parashikuar në buxhetet vjetore për blerje mallrash apo kryerje shërbimesh, të dërgohet pranë APP-së, regjistri i parashikimit dhe realizimit të tyre, në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

3. Komuna Lurë të njoftojë zyrtarisht të gjithë punonjësit e larguar nga puna, dhe të dorëzojnë me procesverbal të rregullt të gjithë dokumentacionin në arkivë ose punonjësve të cilët i kanë zëvendësuar ato.

Menjëherë

4. Komuna Lurë dhe strukturat përkatëse të pasqyrojnë në dokumentet e organizimit të tenderit llogaritjen e fondit limit dhe kostos për vlerat limit të kontratës publike, pasi këto të dhëna kane qellim klasifikim e kontratës sipas kufijve monetare, planifikimin e sakte te fondeve dhe publikimin e tyre.

Vazhdimisht

5. Komuna Lurë të organizojë, kërkojë e marrë pjesë në kurse kualifikimi për punonjësit që marrin pjesë në përgatitjen e procedurave të prokurimit dhe vlerësimit të ofertave, me synim përmirësimin dhe ngritjen e shkallës së kualifikimit.

Deri më Gusht 2014

6. Komuna Lurë dhe sektori i Taksave dhe Tarifave vendore, të marrin masa të menjëhershme, për krijimin e regjistrit tregtar për biznesin e vogël të bëjë programimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të parashikuara në ligjin për biznesin e vogël dhe VKK për çdo subjekt, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”.

Brenda datës 30.09.2014

7. Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore në bashkëpunim me Policinë e komunës, të përcaktojnë llojet dhe masat e gjobave, si dhe t'i propozojnë për miratim Këshillit të Komunës vendosjen e gjobave për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*, neni 6 *“Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”*.

Për çdo vit buxhetor

8. Komuna Lurë, Inspektori i Taksave dhe Tarifave në bashkëpunim me Inspektorin e Pyjeve dhe Bujqësisë, të marrin masa të menjëhershme për kategorinë familjare, për programimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën mbi tokën bujqësore dhe të ndërtesës, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”*.

Brenda datës 30.09.2014

9. Komuna Lurë, Zyra e Financës të bëjë azhurnimin dhe regjistrimin e dokumentacionit të veprimeve kontabël në ditarët analitik në mënyrë kronologjike dhe mbi bazën e të dhënave të hedhura në centralizator, apo në librin e madh të pasqyrohen dhe të dhënat në bilancin kontabël, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin”*, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 dhe udhëzimi MF nr. 14, datë 28.12.2006 ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 *“Për përgatitjen dhe mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2011”*.

Menjëherë

10. Komuna Lurë të rishikojë procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të Policisë, duke zbatuar kriteret e urdhrit të përbashkët të MPVD nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe MRP, nr. 823, datë 11.04.2003 *“Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”*, pikat 4 dhe 5 ku përcaktohet se: asnjë punonjës i policisë bashkiake dhe i komunës, nuk vendoset në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit sipas programit të miratuar për këtë qëllim.

Menjëherë

11. Kryetari i komunës Lurë të marrë masa për zbatimin e marrëveshjes të lidhur me Qarkun Dibër për ushtrimin e funksionit të INUV, të bashkëpunohet duke i kërkuar INUV me shkresë, kryerjen e kontrollit të gjithë territorit të komunës, duke i ofruar evidencën e ndërtimeve pa leje, me qëllim mbajtjen nën kontroll administrimin dhe zhvillimin e territorit, në zbatim të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 *“Për Inspektimin e Ndërtimit”* me ndryshimet.

Brenda datës 30.09.2014

12. Komuna Lurë të marrë masa dhe të kryejë procedurat administrative, bazuar në nenin 116, pika “c” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 *“Për Kodin e Procedurës Administrative”*, për deklarimin të pavlefshëm të **1 kontrate** që i është dhënë toka me qera personave për aktivitet biznesi, si më poshtë:

- Kontrata me subjektin AMC, më datë 05.5.2008, ribërë më datë 3.12.2013. Objekti i kësaj kontrate është: dhënia me qira e (1) sipërfaqe toke e përbërë nga 300 m² për vendosjen e BTS masa, aksesoret e saj, gjenerator antena etj, që do të shërbejë edhe si rrugë kalimi për tek BTS, pasuri e paluajtshme në pronësi shtetërore, e ndodhur në fshatin Lurë, parcela nr. 111 a.

Menjëherë

13. Komuna Lurë të ndjekë procedurat e nisura për kalimin në përdorim apo në pronësi të tokave bujqësore, trojeve, pyjeve, kullotave, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 i ndryshuar me VKM nr. 1277, datë 23.12.2009, për *“ Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”*.

Vazhdimisht

14. Kryetari i komunës Lurë të nxjerr aktin administrativ për krijimin dhe funksionimin e zyrës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës ZAMT, për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, me: kreu II nenin 6, kreu III neni 10, neni 11 pikat a,b,c,c,d, dh, e, ë, nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, ku përcaktohet: kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës, si funksion i tyre sipas përcaktimit në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Brenda vitit 2014

15. Komuna Lurë në të ardhmen, të marrë masa që kontratat para se lidhen ti shqyrtojë dhe miratojë në këshillin e Komunës, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, neni 32, shkronja (ë), detyrat e këshillit bashkiak ose komunal.

Vazhdimisht

16. Kryetari i komunës Lurë, lidhur me problemin e ujësjellësin e fshatit Lurë, të nisë procedurat për verifikimin e titullit të pronësisë në ZVRPP Peshkopi, sipas pretendimeve të banorit që është bërë pengesë, si të thërras për diskutim në seancë dëgjimore, palët e interesit, që janë pjesë e këtij konflikti dhe kryeplakun e fshatit Lurë, për të arritur një marrëveshje që ti hapë rrugë përfundimit të ujësjellësit dhe furnizimit të zonës me ujë të pishëm.

Menjëherë

17. Komuna Lurë të përgatisë materialin dhe dërgojë për analizë në Këshillin e Komunës të pagesave të kryera në shumën 509,500 lekë, për pagesa të kryera për udhëtim e dieta nga e cila: për vitin 2011 në 16 raste në vlerë 206.000 lekë, 2012 në 20 raste në vlerë 172,000 lekë dhe 2013, në 17 raste në vlerë 131,500 lekë. Nisur nga fakti që komuna Lurë është zonë e thellë malore dhe gjatë periudhës së dimrit nëntor- prill aksi rrugor Lurë-Arras- Peshkopi, bllokohet nga bora dhe si e tillë ka lindur nevoja për shpenzime udhëtimi e dieta, për këtë arsye ti lihet për kompetencë dhe vlerësim Këshillit të Komunës Lurë të vendos për dëmshpërblimin.

Deri më 30.09.2014

18. Komuna Lurë të përgatisë materialin dhe dërgojë për analizë në Këshillin e Komunës të pagesave të kryera në shumën 126,270 lekë, për orë jashtë kohës normale të punës nga e cila: për vitin 2011 në vlerë 81,000 lekë dhe 2013 në vlerë 45,270 lekë, përdorur orë jashtë kohës normale të punës, në rastin e emergjencës nga rënia e zjarrit në parkun kombëtar të komunës Lurë, ku rrethanat kanë kërkuar që të punohej jashtë orarit zyrtar të punës, për këtë arsye ti lihet për kompetencë Këshillit të Komunës Lurë për të vendosur për dëmshpërblimin, në zbatim të ligjit nr. 8652 dhe ligjit “Për Kontabilitetin”.

Deri më 30.09.2014

B. MASA SHPERBLIM DËMI:

- Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Lurë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat në vlerën **861,027 lekë** lekë si më poshtë

1. Për vlerën **737.000 lekë** për pagesa të kryera për udhëtime e dieta në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, për periudhën kur aksi rrugor Lurë arrëz peshkopi, ka qenë i hapur.

Deri më 30.09.2014

2. Për vlerën **124,027 lekë**, për pagesa të kryera më tepër për tetë punonjës nga e cila :Për vitin 2011 në vlerë **30,000 lekë**, vitin 2012 në vlerë **61,134 lekë** dhe **2013 në vlerë 32,893 lekë**, në kundërshtim, pika 16 dhe 18, të VKM nr. 1619, datë 2.7.2008, ndryshuar, me VKM nr. 693 datë 18.08.2010, VKM nr. 553 datë 11.08.2011, nr. 518 datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013.

Deri më 30.09.2014

C. MASA DISIPLINORE:

- Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim.”

1. Për **A.D.** me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për të meta dhe mangësi, pasi nuk ka marrë detyrën në dorëzim me proces verbal dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizmin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” germa f, neni 82 si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore, nuk ka mbajtur regjistrin tregtare, nuk ka programuar dhe ndjekur detyrimet tatimore për biznesin e vogël.

2. Për **F.T.** me detyrë përgjegjës i zyrës së financës dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit për blerje me vlera të vogla.

- Për të meta dhe mangësi, për pagesa të kryera për udhëtim e dieta në kundërshtim me kap. III- të pika 1, pika 3 germa ii) dhe germa b) të VKM nr. 997, date 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

- Për likuidimin e qirasë paradhënie sipas kontratave të lidhura ndërmjet palëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

- Për pagesa të kryera, në kundërshtim me VKM Nr. 463 datë 16.06.2011 i ndryshuar, për pagesa të kryera më tepër.

- Për mos zbatimin e planit të buxhetit në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, sipas klasifikimit buxhetor, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për veprimet, blerje me vlera të vogla, pasi veprimet e titullarit të autoritetit Kontraktor dhe të komisionit për blerjet me vlerë të vogël, nuk përputhen me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

3. Për **H.Gj.** me detyrë inspektor i policisë komuna Lurë për të meta dhe mangësi, pasi nuk ka programe vjetore dhe mujore të miratuar nga kryetari i komunës për punën e policisë së komunës,

- Për mungesë kontrolli ndaj fugonave që operojnë pa licencë, për periudhën e auditimit janar 2011-2013,

- Për mos mbajtjen e akt konstatimi dhe pa vendosur sanksionet ligjore, për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 i ndryshuar “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”.

4. Për **D.V.** me detyrë sekretar këshilli komuna Lurë, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla.

5. Për **Xh.B.** me detyrë përgjegjës i zyrës së ndihmës ekonomike komuna Lurë, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla

6. Për **Y Gj.** me detyrë inspektor arkiv protokoll komuna Lurë, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet e vogla, si më poshtë:

Për të meta dhe mangësi, pasi veprimet e titullarit të autoritetit kontraktor dhe të komisionit për blerjet me vlerë të vogël, nuk përputhen me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2001 i ndryshuar “Për Prokurimin Publik”.

7. Për **B.Gj.** me detyrë inspektor bujqësie dhe pyjesh.

- Për mos ngritjen e zyrës së administrimit dhe mbrojtjen e tokës ZAMT. në kundërshtim me ligji nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për kryerjen dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar, me VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë”,

- Për mos përmbushjen e kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore për lidhjen e kontratës, me subjektin “AMC” Komuna Lurë pronat objekt i kësaj kontrate nuk i ka të regjistruara paraprakisht në ZVRPP Peshkopi në emër të saj dhe si të tilla nuk ka asnjë të drejtë posedimi mbi to, në zbatim të neni 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” Kontrata nuk është e regjistruar në ZVRPP Peshkopi në kundërshtim me: Nenet, 144, 193, 197, të kodit civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999 dhe nr. 8781, datë 3.5.2001.

Nga Komuna Lurë, Dibër me shkresë nr.105, prot, datë 18.08.2014, protokolluar në KLSH me nr.447/8 datë 20.08.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Dorino Meço, Din Zeneli dhe Selman Hysa, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT